

VENDIM
Nr. 146, datë 6.6.2022

**MBI SHTYRJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT PËR DHËNIEN E
AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT QË KONTROLLON
INTERESAT E SHOQËRISË “HEC-i KABASH POROCAN” SHPK**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; 67 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.6.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 866/9 prot., datë 2.6.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi dhënien e autorizimit ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “HEC-i Kabash Porocan” sh.p.k.”,

konstatoi se:

- Shoqëria “HEC-i Kabash Porocan” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 93, datë 28.7.2015 si dhe në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 94, datë 28.7.2015.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 196/1 prot., datë 17.2.2022, shoqëria ka paraqitur kërkesë dhe dokumentacion për marrjen e autorizimit për ndryshimin e ortakut kryesor të saj, nëpërmjet shitjes së 100% të kuotave nga shoqëria “Erpa Invest” sh.p.k. te shoqëria “Duferco Albania” sh.p.k.

- Pas shqyrtimit paraprak të kërkesës dhe dokumentacionit bashkëlidhur, rezultoi se kishte mungesë dokumentacioni, ndaj ERE iu drejtua me shkresën nr. 196/2 prot., datë 24.3.2022, duke i evidentuar sa më sipër.

- Në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 196/3 prot., datë 7.4.2022, shoqëria ka depozituar informacion dhe dokumentacion, por duke qenë se ky aplikim nuk ishte ende i plotë dhe duke marrë në konsideratë faktin që shoqëria nuk ishte plotësisht e qartë në lidhje me dokumentacionin e këtij aplikimi, ERE i dërgoi shkresën vijuese me nr. 196/5 prot., datë 18.5.2022. Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 196/6 prot., datë 23.5.2022, shoqëria ka depozituar të gjithë dokumentacionin e kërkuar.

- Në mbështetje të nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me qëllim sqarimin/dokumentimin e mbështetjes financiare, vlerësohet e arsyeshme shtyrja me 30 ditë pune e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë “HEC-i Kabash Porocan” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë pune vendimmarrjen përfundimtare të Bordit të ERE-s në lidhje me kërkesën e shoqërisë “HEC-i Kabash Porocan” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja

që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti